



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.01.2019, ora 09:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit trejavor të punimeve të Komisionit.
2. Miratimi i procesverbalit për datën 3 dhe 17 dhjetor 2018.
3. Projektligji “Për ratifikimin letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.
5. Çështje të tjera.

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Reme Lala, Klajda Gjoshja, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti.

#### **Mungojnë:**

Tritan Shehu, Ditmir Bushati, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Ervin Bushati

#### **Të ftuar:**

Dorina Çinari- Zëvendësministre për Infrastrukturën dhe Energjinë

Agim Bregasi- Drejtor në Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë

Fatos Bundo- Drejtor i KESH-it

Anisa Pine-shefe Sektori në Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Aida Hajnaj – zëvendësdrejtoreshë e Kufirit

Renata Balliu- përgjegjëse e Sektorit të Këshillimit Ligjor në Drejtorinë e Programimit,  
Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Tomor Duro - shef Sektori në Drejtorinë e Kufirit

Silvana Dervishi – specialiste në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe  
Asistencës

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë këtë sesion të ri parlamentar. Mbledhja e parë e komisioneve parlamentare bëhet nga ky komision, i cili ka specifikat e tij të veçanta. Më mirë që ndodhi kështu, sepse i bie që mbledhjet e tjera të komisioneve t'i kemi të mbara, produktive, konstruktive, pse jo edhe me debat, por në nivelin e duhur ashtu siç e meriton Komisioni i Politikës së Jashtme.

Dua t'u uroj anëtarëve të rinj të komisionit mirëseardhjen, punë të mbarë!

Shpresoj shumë që me prezencën e anëtarëve të opozitës ky komision të ketë vlerat e merituar.

Kalojmë në rendin e ditës.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të komisionit. Nëse jeni në dijeni të materialit që keni përpara, unë ju ftoj ta miratojmë ashtu siç ka ardhur.

Pika tjetër e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 3 dhe 17 dhjetor 2018. Nëse jeni dakord i miratojmë edhe procesverbalet.

Në një pikë tjetër të rendit të ditës kemi dy projektligje, ku komisioni ynë është për dhënie mendimi. Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012” dhe projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Të ftuar për diskutime për projektligjin e parë kemi zonjën Çinari, zëvendësministre për Infrastrukturën dhe Energjinë, zotin Agim Bregasi, drejtor në Ministrinë për Infrastrukturën dhe Energjinë, zotin Bundo, drejtor i KESH-it, dhe zonjën Pine, shefe sektori. Mirë se keni ardhur!

Zonja Çinari, fjala për ju.

**Dorina Çinari** – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot kemi sjellë për miratim projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar

me ligjin nr. 40/2012”. Siguria e digave është një projekt i madh, ka filluar që në vitin 2008, ka katër donatorë: IBRD-in, Bankën Botërore, KfW-në dhe SECO-n, por në këtë rast flasim për një marrëveshje që është nënshkruar me IBRD-në. Sigurisht, qëllimi i gjithë projektit është të përforcohet dhe të monitorohet siguria e digave, që më pas të kemi siguri të furnizimit me energji elektrike dhe të sistemit elektroenergjetik.

Sot para jush kemi sjellë vetëm një rialokim fondesh nga një zë, që është zëri i asistencës teknike, në një zë, që është investime, brenda përbrenda vlerës së investimit pa ndryshuar tavanin. Thjesht rialokim nga zëri i asistencës teknike në zërin investime në masën 461 mijë e 250 euro. Kjo është shuma që kemi ardhur të miratojmë bashkë me ju.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Çinari, për prezantimin shterues!

Urdhëroni, zonja Kushi!

Më pas kalojmë në pyetje dhe diskutime.

**Evis Kushi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke mos dashur të përsëris ato që tha zonja zëvendësministre, po flas shkurt.

Projektligji synon ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”.

Sipas relacionit, dy janë qëllimet kryesore:

Së pari, kalojnë shpenzimet nga një zë në një zë tjetër, konkretisht nga kategoria e katërt, në kategorinë e parë. Domethënë, nga një kategori e papërcaktuar, në kategorinë mallra dhe punime.

Së dyti, shtyhet afati për vitin 2020.

Në fakt, dua t’ju pyes: kur ka qenë afati, sepse në relacion nuk e kemi se cili ishte afati kur duhet të përfundojnë punimet, që është shtyrë deri në vitin ’20? Cila është arsyeja pse këto punime po shtyhen deri në vitin ’20 dhe pse nuk kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Gjoshë!

**Klajda Gjoshë** - Faleminderit për prezantimin!

Projekti që ne kemi përpara, përveçse ka filluar që nga viti 2008, ka një rëndësi të veçantë, por ajo çka mua më bën gjithmonë përshtypje, (në fakt, kjo nuk vlen vetëm për ju, por të gjitha

ministritë kanë të njëjtin problem), nuk e di si planifikohen këto projekte, sepse gjithmonë ka shtyrje në kohë të afateve dhe në çdo moment këtu vijnë kërkesa për ndryshime fondesh nga njëri zë tek tjetri. Unë nuk besoj se kjo tregon një seriozitet edhe ndaj donatorëve apo partnerëve që ne punojmë dhe financojnë këto projekte.

Pyetja ime është: a i kishit planifikuar ju që më parë të gjitha këto investime që kërkonti të bëni tani, pas kaq vitesh, dhe pse është bërë kjo shtyrje në kohë? Pse është shkaktuar shtyrja e afatit që kërkonti sot?

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Profesor Panariti, pastaj zonja Hysi.

**Edmond Panariti** – Titulli i projektligjit, siç e shoh unë të shkruar, stonon me përmbajtjen e tij. Në qoftë se do ta lexojmë *ad litteram* projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për financim shtesë, nuk bëhet fjalë për financim shtesë, sepse, po të ishte financim shtesë, presupozohet që nga vlera e alokuar të kërkohet një shtesë mbi fondin ekzistues, kurse më poshtë ju e kundërshtoni. Unë prisja që ju vërtet të aplikoniit për një financim shtesë, që, në fakt, do të ishte një kredi shtesë, sepse, me sa di unë, nuk është grant. Për këtë duhej të ishit përgatitur dhe të na sqaronit pse kërkohej ky financim. Në fakt, këtu kërkohet një rishpërndarje, e cila natyrisht kërkon një sqarim pse ky fond prej 461 mijë e 250 euro, i planifikuar për një zë tjetër nuk realizohet për këtë zë dhe pse kërkohet të spostohet tashmë për zërin e punimeve. Pra, pyetja ime është: pse stonon titulli me përmbajtjen? Duhet që në titull të specifikohet qartë se nuk bëhet fjalë për financim shtesë, por për rishpërndarje të fondeve.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, po lexoj relacionin dhe për mua është e qartë pse ju kërkonti një rishpërndarje. Në pikën dy të relacionit thoni se, pasi keni hapur hidroagregatët, keni parë problematika shtesë, të cilat nuk mund t'i parashikoniit që në fillim, por mua më bën përshtypje një paragraf tjetër, ku thoni se qëllimi i kësaj letërmarrëveshjeje është shpërndarja e fondeve, me qëllim financimin e konsulencës teknike për supervizimin e punimeve shtesë. Ndërkohë, nuk shoh fonde për financimin e konsulencës teknike, por thjesht fonde që kalojnë nga kategoria 4 te kategoria punime shtesë “Mallra dhe shërbime”. A është edhe ky objektivi i këtij projektligji?

**Mimi Kodheli** – Po, zonja Çinari.

**Dorina Çinari** – Afati i mbylljes së financimit, sipas marrëveshjes origjinale, ka qenë viti 2019. Duke qenë se nëpërmjet shtesës, ose rialokimit të fondeve, ne kërkojmë të bëjmë punime civile ekstra, natyrisht që ato kërkojnë kohën e duhur, sepse punimet në infrastrukturë kërkojnë kohë. Pra, në jemi të detyruar të marrim kohë ekstra.

Letërmarrëveshja është përcjellë pranë jush nga Ministria e Financave.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është përcjellë te ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po i përgjigjem ministrit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sipas qëndrimit tonë, ne nuk duhet të ishim paraqitur në komisionet parlamentare për ta miratuar këtë, pasi është thjesht një rialokim fondesh dhe në marrëveshje nuk kërkohet që ne të vijmë para komisioneve parlamentare për rialokim fondesh, por bëhet thjesht me një vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky akt është përcjellë pranë jush nga Ministria e Financave, sipas instruksioneve të Ministrisë së Drejtësisë, dhe ne jemi të detyruar të ndjekim instruksionet tani.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të mbrojmë qëllimet pse e sjellim aktin këtu.

Pra, zëri i katërt, të cilit iu referua zonja Hysi, është asistenca teknike.

Kanë përfunduar të gjitha detyrat e lëna brenda këtij zëri dhe kjo është një sasi fondi e kursyer. Janë ezauruar tenderët, konsulencat, veprimtaritë që i përkasin këtij fondi dhe kjo është kursyer. Sasia e kursyer e fondit është dakordësuar me donatorin që të përdoret për investime, sepse nuk mjafton. Ne, edhe me gjithë sasinë e fondit total që kemi në dispozicion prej 96 milionë eurosh, nuk do të arrijmë ta përfundojmë 100% projektin e madh të digave, por do të ketë përsëri nevoja shtesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Po, zoti Bregasi.

**Agim Bregasi** – Në përgjigje të pyetjes së zonjës Gjoshë, natyrisht ky është një projekt i madh, i filluar që në vitin 2008, ku janë angazhuar shumë donatorë, me kredi ose me fonde grant, por punimet për të cilat janë dhënë këto fonde kanë qenë edhe punime të maskuara, të fshehura, të

cilat ne nuk i dinim, madje nuk i dinte asnjëri, as ai që ka bërë dokumentet e tenderit nuk e dinte se në çfarë gjendjeje do t'i kishin agregatet kur të hapeshin.

Pasi u hap agregati i parë, i dytë, i tretë (pra turbinat, gjeneratorët dhe aksesorët e tyre) u pa se dëmtimi i tyre ishte më i madh nga sa ishte parashikuar, po themi, para dhjetë vjetësh, dhe kërkonte punime shtesë. Natyrisht, punimet shtesë do të kërkonin financim dhe financimi është konsideruar i mjaftueshëm. Ky që ka qenë për një zë tjetër, që do të kalojë tani në zërin e investimeve, pra pikërisht në punime të rehabilitimit të mirëfilltë të turbinave, gjeneratorëve dhe aksesorëve të tjerë të centralit.

Them se është fat që ka qenë ky 461-shi, se ndryshe do të ishim detyruar të merrnim kredi shtesë, por kërkohet vetëm rialokimi nga zëri që ishte dhe që tani nuk po përdoret më, sepse ka tepruar, duke kaluar te zëri i kategorisë së parë, që janë investimet e mirëfillta.

Natyrisht, pasi u panë edhe punimet, u konsiderua që edhe për të shlyer kredinë apo edhe financime të tjera, nuk do të mjaftonte viti 2019. Ndaj, në bashkëpunim edhe me Bankën Botërore, është rënë dakord që kjo ta ketë afatin e disbursimit deri në vitin 2020. Pra, të dy zërat, edhe punimet shtesë, pra justifikimi i fondeve shtesë për të kaluar tek investimet, edhe koha janë të argumentuar dhe është rënë dakord edhe me donatorët, nëpërmjet shikimit konkret në terren të gjendjes së aggregateve të amortizuara, të korroduara, me kavitacion e të tjerë.

Këto janë. Por duke qenë se është brenda kredisë së madhe, 15,5 milionë euro të IBRD-së të dhëna në vitin 2012, mendojmë se nuk përbën problem, madje është fat që jemi në situatën kur i kemi këto fonde dhe nuk kërkohet financim shtesë. Pra, është rënë dakord me të dyja palët që të përdoret në punime civile të mirëfillta tek turbina, gjeneratori apo aksesorë të tjerë të hidrocentralit të Komanit.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Bregasi!

Mua më vjen mirë që herë pas here ju vini dhe shpjegoni, diku edhe në detaje, një proces të një rëndësie të veçantë kombëtare dhe strategjike siç është energjia, që ka lidhje jo vetëm me sigurimin e energjisë elektrike, por edhe me sigurinë.

Do të ftoja Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe qeverinë shqiptare të mos sjellin më në parlament rialokime, sepse ne nuk jemi Ministria e Financave dhe as Thesari, por komision parlamentar që vendosim, diskutojmë dhe miratojmë ose jo fonde të përdorura, nga taksapaguesit shqiptarë apo nga donatorë të huaj, të hedhura në letër nëpërmjet projektligjeve që sillen.

Kështu që, nëse jemi tjetër herë të interesuar për mbarëvajtjen e punimeve dhe rikonstruksionin e agregateve të Komanit, jam e bindur që ju jeni të hapur ta sqaroni këtë gjë sa herë që ne ta kërkojmë, por jo domosdoshmërisht kjo të vijë kur nuk është e nevojshme. Komisioni i Politikës së Jashtme e kalon këtë projektligj për shkak se duhet të shikojë përputhshmërinë me legjislacionin ndërkombëtar, por, gjithsesi, ne jemi anëtarë të parlamentit dhe kemi nevojë të informohemi.

Kështu që, thirrja ime është publike. Herë tjetër Ministria e Drejtësisë duhet të shikojë se kur duhet të sjellë një projektligj për t'u riparë në komisionet respektive. Në këtë rast, për aq sa e njoh legjislacionin, por edhe si ligjvënëse, jam e bindur se nuk ka qenë e nevojshme që ju të vini të kërkonit për një rialokim. Ne nuk jemi as Drejtorja e Thesarit, as Ministria e Financave dhe as qeveria.

Ju faleminderit për prezencën!

E kalojmë për miratim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, profesor.

**Edmond Panariti** – Unë dua të ngre një problem që nuk lidhet vetëm me projektligjin që paraqitet këtu, por me një fenomen që për mua është bërë tashmë endemik. Pra, në çfarëdo lloji investimi, qoftë investim rehabilitimi si në rastin e digave, qoftë rikonstruksion rrugësh, ne ndodhemi përpara situatave të ngjashme, ku bëhet një preventiv paraprak, përcaktohet një vlerë, por kur futemi në fazën e investimit na thuhet që nuk e menduam se do të na ndodhnin këto defekte prandaj kërkojmë fonde shtesë. Shtegu për abuzim këtu është jashtëzakonisht i madh. Për shembull, në rastin konkret unë do të doja një shpjegim për zërin e katërt. Pse u mbiplanifikuan para për zërin e katërt dhe u nënplanifikuan për fondin operacional? Për sa kohë që e sollët këtu, këtu kërkohet shpjegim. Në qoftë se do ta mbyllni me VKM, e mbyllni me VKM. Për sa kohë e sillni në parlament dhe përpara deputetëve, ne kërkojmë argumente të plota. Gjithashtu, nuk mora përgjigje për titullin, i cili nuk rakordon me përmbajtjen. Titulli presupozon financim shtesë, por ky nuk është financim shtesë, por rishpërndarje e fondit brenda fondit të alokuar.

Prandaj, kërkohet më tepër seriozitet në përcaktimin e emërtesës së projektligjit, që do ta kaloni këtu dhe në seancë plenare, sigurisht edhe shpjegime të mjaftueshme, sepse bëhet fjalë për para konsistenti, 461 mijë euro, të cilat na dalin plus.



Kërkoj një shpjegim: Pse u planifikuan me tepricë, ndërkohë që kemi nënplanifikim të zërat e tjerë?

Këto gjëra duhen sqaruar, në mënyrë që edhe ne të jemi të qartë para se të vendosim për të dhënë apo jo votën për një projektligj të tillë.

Mua s'më duket i ndërtuar drejt si projektligj, që nga titulli i cili disponon përmbajtjen. Pra, duhet të kemi shumë kujdes para se të vijmë këtu.

**Mimi Kodheli** – Ndaj shqetësimin tuaj, profesor. Unë mendoj që projektligji, ashtu siç thatë, është emërtuar që në fillim i tillë dhe nuk i takon institucionit ta çemërojë, sepse i bie që të kalojmë në një ligj tjetër, po të ketë një emër tjetër.

Kështu që për çdo riratifikim të një marrëveshjeje do të na duhet të përdorim të njëjtin emërtim ligji, e para.

E dyta, unë jam e bindur që zoti Bregasi, për aq sa e njoh karrierën e tij, duhet të ketë qenë edhe vitin 2012, përndryshe do të na duhet të thërrisim ekspertët e asaj qeverie dhe të asaj epoke për të kuptuar se pse fondet dhe zërat përkatës janë përcaktuar në një formë dhe sot dalin me disa shqetësime të tjera.

Megjithatë, nëse është nevojshme të thirren ekspertët e viti 2012 dhe ish-ministrat e asaj kohe, çdo njeri i asaj kohe, këtu besoj se ka aq mirëkuptim që po qe se është e nevojshme ne ta rishikojmë këtë, por procesi i rialokimit dhe fenomeni i rialokimit është një proces dhe një fenomen që nuk është i kundërligjshëm.

Urdhëroni, profesor Andrea!

**Andrea Marto** – Zonja kryetare,

Dua të bashkohem me shqetësimin e kolegëve, por edhe të theksoj një anë pozitive të këtij ndryshimi.

Deri tani ne jemi ankuar për shumën e madhe të parave që shkonin për konsulencë teknike, tani kemi një sukses se paratë e konsulencës teknike shkojnë për investime dhe mallra. Pra, duhet të shohim pozitivisht këtë zhvillim dhe, siç thanë edhe ekspertët, programimi, planifikimi në vepra të tilla është mjaft i ndërlikuar.

Unë them ta miratojmë.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Urdhëroni!

**Evis Kushi** – Nisur nga shqetësimi i profesorit kam përshtypjen që marrëveshja origjinale është për një financim shtesë dhe ne po ndryshojmë këtë, me sa kuptoj.

Pra, titulli “Financim shtesë” është te marrëveshja origjinale.

Faleminderit!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** - E hedhim në votim? Kush është dakord me ndryshimet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Politikën e Jashtme*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.01.2019, ora 09:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Elona Gjebrea, Eglantina Gjermeni, Evis Kushi, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Reme Lala, Klajda Gjoshja, Rudina Hajdari dhe Edmond Panariti.

#### **Mungojnë:**

Tritan Shehu, Ditmir Bushati, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Ervin Bushati

#### **Të ftuar:**

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Aida Hajnaj – zëvendësdrejtoreshë e Kufirit

Renata Balliu- përgjegjëse e Sektorit të Këshillimit Ligjor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Tomor Duro - shef Sektori në Drejtorinë e Kufirit

Silvana Dervishi – specialiste në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës

**Mimi Kodheli** - Kalojmë të projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Të pranishëm janë : zoti Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm.

Mirë se vini!

Zonja Aida Hajnaj, zëvendësdrejtoreshë e Kufirit, zonja Renata Balliu, përgjegjëse e Sektorit të Këshillimit Ligjor, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, zoti Tomor Duro, shef Sektori, Drejtorja e Kufirit, zonja Silvana Dervishi, specialiste në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës.

Mirë se vini!

Zoti Hodaj fjala është për ju.

**Julian Hodaj** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë, marrëveshja që po shqyrtojmë sot është një marrëveshje kuadër që përcakton kornizat e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian. Është një marrëveshje, e cila fokusohet në statusin e oficerëve që do të operojnë në Shqipëri dhe do të pasohet me një marrëveshje operacionale për sa u përket detajeve dhe procedurave të veprimeve në terren.

Pjesa kryesore e marrëveshjes është imuniteti nga juridiksioni penal në atë civil, që këta oficerë do të kenë në Republikën e Shqipërisë, por që lidhet me akte apo veprime të kryera në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe në rast të kundërt nuk e gëzojnë këtë lloj imuniteti. Pra, pak a shumë është ai lloj imuniteti që u garantohet diplomatëve të huaj, do të akreditohen. Veprimet operacionale që mund të kryhen janë gjithmonë në praninë ose të shoqëruara nga forcat e policisë shqiptare që janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të kufirit.

Kjo marrëveshje është sigluar fillimisht, në mos gaboj në muajin shkurt të vitit 2018, është miratuar nga Këshilli i Ministrave në parim në muajin maj të vitit 2018 dhe përfundimisht është lidhur ndërmjet BE-së dhe Republikës së Shqipërisë më 5 tetor të vitit 2018 gjatë ministerialit të ministrave të Brendshëm të Ballkanit dhe të BE-së që u zhvillua në Tiranë.

Në gjykimin tonë, kjo është një mundësi e mirë për Policinë e Shtetit, së pari për marrjen e një eksperience dhe asistence me standardet e BE-së, si edhe një certifikim të standardeve të përdorura sot nga Policia e Shtetit në menaxhimin e integruar të kufirit.

Policia shqiptare përfiton edhe mbështetje logjistike në kuadër të modernizimit të saj me mjete teknologjike, pasi flasim për një agjenci europiane që ka mjete të konsiderueshme financiare dhe teknike, të cilat besojmë se një pjesë e mirë e tyre do të vihen edhe në dispozicion të Policisë së Shtetit. Siguron një shkëmbim më të mirë të të dhënave dhe të informacionit ndërmjet policisë shqiptare dhe agjencive të tjera ligjzbatuese europiane, për sa kohë do të kemi oficerë prezentë në territorin e Shqipërisë që do të kryejnë operacione bashkë me Policinë e Shtetit.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, dua të them se kjo marrëveshje është e para e këtij lloji në rajon. Shqipëria ka qenë mjaft e vlerësuar për këtë nismë. Marrëveshjet e të njëjtit lloj po negociohen me Maqedoninë, janë në fazë të avancuar dhe besoj se shumë shpejt edhe ato do ta kalojnë, si edhe me Serbinë.

Shqipëria është i pari vend i rajonit që lidh një marrëveshje të tillë, pasi është një lloj lideri në rajon në këtë aspekt.

**Mimi Kodheli** - Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Përpara se t'i a jap fjalën zonjës Gjebrea si relatores e këtij projektligji, më lejoni të ritheksoj edhe një herë se këtu vihet, sepse oficeri i Frontekstit duhet të ketë statusin e diplomatit, ndaj kjo kërkon pikërisht këtë procedurë për të cilën po flasim. Pra, kjo gjë kërkon këtë status dhe kjo është arsyeja pse vihet këtu për t'u diskutuar ky projektligj për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Po, zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç u shpreh edhe zëvendësministri, kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme dhe unë dua të ritheksoj faktin se është e para e këtij lloji në rajon. Pra, bashkëpunimi operacional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së, ku ne synojmë të bëhemi anëtar, realizohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, sepse këtu bëhet fjalë edhe për veprime operationale në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, vlen për t'u theksuar fakti i krijimit të kuadrit rregullator ndërmjet agjencisë dhe ekipeve të saj dhe autoriteteve tona. Kështu, kjo tregon edhe një herë frymën e bashkëpunimit që ka Ministria e Brendshme me Frontekstin. Në fakt, nuk e shoh asgjëkundi në marrëveshje fjalën Frontekst të vendosur në kllapa. Unë nuk e di se si janë rregullat dhe ku duhet të shkruhet, por, meqenëse të gjithë e njohim kështu, mendoj se duhet të ishte përcaktuar dhe të vihej në kllapa. Megjithatë, kjo nuk ka asnjë lloj rëndësie, sepse e rëndësishme është mundësia që ky bashkëpunim koordinon edhe operacionet në rastin e flukseve të

emigracionit, duke ritheksuar faktin se flukset e emigracionit janë gjithmonë me ulje dhe ngritje. Kështu, kjo nuk do të thotë se ne nuk do të përballemi përsëri me një fluks emigracioni nga jashtë, sikurse kemi vënë re deri tani, sepse në këtë mënyrë ne jemi edhe më të organizuar.

Dua të theksoj se kjo marrëveshje nuk ka efekte financiare, përkundrazi, sikurse e tha edhe zëvendësministri, do të kemi mbështetje edhe me logjistikë. Kështu që kjo është përsëri në të mirë edhe të Policisë Kufitare dhe asaj shqiptare dhe, patjetër, në tërësi edhe të Ministrisë së Brendshme.

Duke e përshëndetur këtë marrëveshje, ju ftoj që ta miratoni.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

A ka pyetje?

Po, fjala për ju, zonja Hajdari.

**Rudina Hajdari** – Atëherë, a mund të bëj një koment?

**Mimi Kodheli** – Po, patjetër!

**Rudina Hajdari** - Falënderoj pjesëmarrësit!

E dëgjova me vëmendje prezantimin zotit Hodaj, ndaj dua të sjell në vëmendje se kjo marrëveshje nuk vjen si një marrëveshje, e cila duhet veçuar nga marrëveshjet tjera në rajon, por vjen si pasojë e ngjarjeve që ka kaluar Shqipëria në vitet e fundit. Duke qenë se nuk e bënit dot detyrën tuaj, kjo marrëveshje ju ka ardhur si ndihmë shtesë për punën që duhet të kishit bërë deri tani. Nga vendet e tjera të rajonit ka pasur kalime të personave të paligjshëm, por, gjithashtu, ka pasur edhe aktivitete të trafikut të drogës, kështu që, para se të flasim për këtë marrëveshje si një arritje e madhe për shtetin, ne duhet të flasim edhe për ato që, në fakt, vijnë në sajë të kësaj mbështetjeje, duke qenë se ne i kemi eksportuar këto problematika në Bashkimin Europian. Ato vijnë për të na ndihmuar, duke qenë se ne nuk jemi në gjendje ta bëjmë këtë punë për veten tonë. Duke thënë këtë, them që është një iniciativë shumë e mirë, sepse dua që shteti ynë të jetë i sigurt dhe të përmbushë të gjitha kriteret dhe normat e sigurisë që Bashkimi Europian kërkon ndaj nesh. Në këtë kuadër mendoj që është një marrëveshje e mirë, por duke marrë parasysh edhe problematikat që kemi pasur vitet e fundit.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zonja Hajdari!

A ka komente të tjera? Pyetje?

Fjalën e ka zoti Hodaj.

**Julian Hodaj** – Falënderoj zonjën deputete për komentimin, por kam përshtypjen se atyre që iu referua, nuk i korrespondojnë të vërtetës, sepse dikush që e ka idenë se si funksionon Frontex dhe dikush që ka udhëtuar nëpër Europë, e ka parasysh që në të gjitha pikat e kalimit kufitar, si në Kroaci apo në Itali, nëse flasim në raport me Shqipërinë, ka gjithmonë prezencë të Frontex-it, sepse operohet në kuadër të rregulloreve europiane për menaxhimin e integruar të kufirit.

Ne besojmë që është një vlerë e shtuar dhe nuk ka lidhje me asnjë nga ato probleme që u përmendën, sepse certifikon ato standarde që Policia e Shtetit po i aplikon prej vitesh në menaxhimin e integruar të kufirit.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Po, zonja Hajdari!

**Rudina Hajdari** – Zoti Hodaj, unë e kuptoj sesi funksionon Frontex-i. Ne kemi udhëtuar në Bashkimin Europian, së bashku me kryetaren e komisionit dhe të mos harrojmë se një nga temat kryesore që është ngritur në takimet e ngushta ka qenë kalimi i mbi 1000 emigrantëve të paligjshëm nëpërmjet territorit të Shqipërisë në vitin 2018. Prandaj të mos i anashkalojmë këto probleme, por të tregohemi të sinqertë.

**Elona Gjebrea** – Unë dua të them dy komente. Shqipëria nuk është e veçuar, sepse migracion të parregullt ka edhe Franca e Italia, dhe të gjithë i kemi parë imazhet e emigrantëve nga vendet e treta që kanë zbarkuar në Itali apo Francë. Sikurse e tha edhe zëvendësministri, këtu bëhet fjalë për një menaxhim të integruar të kufirit, e cila është direktivë e BE-së. Me këtë marrëveshje ne jemi më të bashkërenduar në punën e tonë me vendet e BE-së. Prandaj kjo është një iniciativë për t'u përmendur dhe nuk duhet të ngatërrojmë shifrat, të cilat nuk janë vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera shumë më të përparuara se ne.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Po, zoti Panariti!

**Edmond Panariti** – Mesa arrita ta kuptoj nga përmbajtja dhe nga sqarimi që u bë, këtu bëhet fjalë për menaxhimin e flukseve migratore, por jo të trafikeve në total. Pra, është një marrëveshje, e cila në nenet e këtij projektligji nuk përmendet në mënyrë specifike për kontrabandën, trafiket e drogës e të tjera. Pra është një masë preventive dhe koordinuese, për...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, pra. Po them që është shumë specifike, sepse termi “kontrabandë dhe trafik” është shumë i gjerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Termi “menaxhim i koordinuar i kufirit” është tepër kompleks dhe nuk ka të bëjë vetëm me njerëzit, por edhe me mallrat, me kontrabandën apo trafiqet e drogës.

**Mimi Kodheli** – Zonja Gjermani, fjala është për ju.

**Eglantina Gjermani** – Faleminderit, kryetare!

Na vjen mirë që opozita është këtu. Na keni munguar me pyetjet, diskutimet dhe debatet që hapni, sepse vërtet diskutojmë më shumë.

Doja të ritheksoja atë që, në fakt, e kemi edhe në relacion. Theksohet se më anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i bashkëpunimit në fushën operationale, për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkuftar, si dhe kryerjen e operationeve të kthimit dhe ripranimit për menaxhimin e kufijve.

Në momentin kur flasim për menaxhimin e kufijve dhe sidomos për vendet e Bashkimit European, sigurisht edhe ato kanë interes të rrisin kapacitetet, të bashkëpunojnë me ne, që në vendet e tyre të mos ketë emigracion të paligjshëm.

Në këtë kushte, ne jemi vendi që përfitojmë nga kjo marrëveshje, rrisim kapacitetin dhe na jepet mundësia që përmes trajnimeve dhe bashkëpunimeve të ngremë kapacitetin e policisë dhe të policisë kufitare.

Në këto kushte, besoj se është një hap më tej për të qenë një vend më i sigurt dhe për të bashkëpunuar në nivelin që duhet me vendet e Bashkimit European.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit!

Nëse nuk ka komente dhe pyetje të tjera, mendoj ta hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord në parim?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Miratohet.

Neni 2.

Miratohet.



E votojmë në tërësi.

Miratohet.

Ju faleminderit!

Faleminderit, Zëvendësministre! Faleminderit edhe përfaqësuesve!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zonja Hysi.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

Nënkryetarja Hysi, si një person metikoloz, skrupuloz, i legjislacionit shqiptar dhe jo vetëm, kërkon që ta rikthejmë edhe një herë miratimin nën për nën të projektligjit për digat, meqë nuk e kemi miratuar nën për nën.

Neni 1.

Miratohet.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – T’ju kujtoj diçka...

**Mimi Kodheli** – Jemi në proces votimi...

**Vasilika Hysi** – Ka një propozim të...

**Mimi Kodheli** – Jemi në proces votimi, shefe.

Duhet ta rikthejmë edhe një herë nga teknika legjislative... Ia çojmë Komisionit të Ligjeve rekomandimin...

**Mimi Kodheli** - Jemi në proces votimi.

Neni 1.

Miratohet.

Nuk ka nën 2...

**Vasilika Hysi** – Nuk ka asnjë, prandaj duhet vënë neni 1 dhe neni 2.

**Mimi Kodheli** - Kështu që unë kam qenë në rregull, që të mos e kalojmë nën për nën.

Metikoloziteti i zonjës Hysi më nxit të them se e miratojmë edhe në tërësi projektligjin për digat.

Ju faleminderit!

Mbyllet këtu mbledhja e komisionit për sot.

Punë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**